

VENDIM
Nr. 182, datë 8.3.2017

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 10.11.2016, PËR ÇËSHTJEN “ÇELA DHE PETRELA KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR KËRKESËN NR. 15373/15 DHE KËRKESËN NR. 3604/16)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.11.2016, për çështjen “Çela dhe Petrela kundër Shqipërisë”, për kërkesat nr. 15373/15 dhe nr. 3604/16, në shumën 4 400 (katër mijë e katërqind) euro për kërkesin, z. Qazim Çela (aplikimi nr. 48693/08), dhe në shumën 4 700 (katër mijë e shtatëqind) euro për kërkesin, z. Albi Petrela, në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror, si dhe kostot e shpenzimet, duke i përfshirë nga çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkesve, z. Qazim Çela dhe z. Albi Petrela, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.11.2016, për çështjen “Çela dhe Petrela kundër Shqipërisë” (kërkesat nr. 15373/15 dhe nr. 3604/16).

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas pikës 3, të këtij vendimi, në favor të kërkesve, z. Qazim Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i Gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit tremujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e sipërpërmendura paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama